



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Rregulloren (komunale) për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike (subvencione dhe transfere nr.prot.01/111-400 të datës 28 maj 2012 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren nr.prot.01/172-400 të datës 27 shtator 2012, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2021, miratoi këtë,

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumë 10,000.00 €, me destinim për subvencionimin e Klubit të Futbollit Llapi në Podujevës.

Neni 2

Subvencionimi i KF Llapi, sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet me qëllim të stimulimit dhe shpërblimit të lojtarëve dhe stafit të Klubit pas shpalljes fitues i Kupës së Republikës së Kosovës në Futboll dhe përgatitjeve për pjesëmarrje në garat Evropiane.

Neni 3

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria subvencione dhe transfere, në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe e njëjta bartet në xhirrollogarinë bankare të KF Llapi Podujevë.

Neni 4

Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Pas miratimit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot.01-400/03-0045235/21
Podujevë,
04 qershor 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi

[Handwritten signature]